



Република Северна Македонија
Republika e Maqedonisë së Veriut

АПЕЛАЦИОНЕН СУД ГОСТИВАР
GJYKATA E APELIT GOSTIVAR

Ул. Живко Брајковски бр.1, 1230 Гостивар / тел: 042-221-544 / info@asgostivar.mk
Rr. Zhivko Brajkovski nr.1, 1230 Gostivar / tel: 042-221-544 / info@asgostivar.mk

SPI.6p.1/24

Në pajtim me nenin 36 nga Ligji për qasje të lirë të informacioneve nga karakteri publik ('Gazeta Zyrtare e R.M', numër 101 nga data 22.05.2019) Gjykata e Apelit Gostivar rr.Zhivko Brajkovski' nr.1, tel: 042-221-544 dhe faks: 042-221-545, info@asgostivar.mk, si posedues i informacioneve, përmes personit zyrtar Aleksandar Duroski – udhëheqës i sektorit të gjykatës për marrëdhënie me publikun dhe analitikë, përgaditi raportin e mëposhtëm:

RAPORT VJETOR
(nga data 01.01.2023 deri më 31.12.2023)

1. Të dhënat për zyrtarët të përcaktuar për ndërmjetësim me informata tek personat që posedojnë informacionet; Aleksandar Duroski – udhëheqës i sektorit të gjykatës për marrëdhënie me publikun dhe analitikë:
2. Numri i kërkesave të pranuar: 5 (pesë),
3. Numri i kërkesave që kanë pranuar përgjigje pozitive: 4 (katër),
4. Numri i kërkesave të refuzuara dhe të hudhura poshtë me theksim të arsyeve për refuzimin e kërkesës: 1 (një).

Informacioni i kërkuar, nuk është informacion i karkaterit publik, sepse këtë informacion nuk e ka krijuar zyrtari përgjegjës dhe nuk e ka në posedim po të njejtin, dhe nuk është informatë e cila është në kompetenca të Gjykatës së Apelit Gostivar, në pajtim me Ligjin për gjykatat dhe rregulloret tjera ligjore. Nga ana tjetër me informatën e kërkuar për listë të bisedave telefonike nga telefoni zyrtar i kryetarit të Gjykatës së Apelit Gostivar për periudhën janar 2021 deri në dhjetor 2022 bëhet hyrje në privatësinë komunikative të përdoruesit të telefonit zyrtar, duke marrë parasysh që thirrjet telefonike paraqesin pjesë të jetës private të kryetarit të Gjykatës së Apelit Gostivar, mbi baza të përdorimit të telefonit zyrtar në funksion për sigurim të komunikimit më të lehtë dhe më të shpejtë me të punësuarit e tjerë për kryerjen e lëndëve në afatet e parapara ligjore, ndërsa të punësuarit mund t'i përdorin telefonat zyrtar edhe për qëllime personale, duke pasur parasysh që nuk janë përcaktuar kufizime për komunikimin e tyre, nga ku del që edhe e drejta e privatësisë ndërsa në këtë rast çmimi për faturën për përdorim të telefonit zyrtar është informatë e

karakterit publik, por jo edhe lista e bisedave telefonike. Nga ana tjetër në këtë rast bëhet fjalë për kërkesa të drejtuara te personat fizik te të cilët mund të bëhet dëm për nderin dhe reputacionin e tyre nëse kjo informatë bëhet publike, por dëmi mund të bëhet edhe ndaj personave të tretë, për shkak të së cilës me refuzimin e qasjes deri te ky informacion i kërkuar, pasojat mbi interesin që mbrohet janë më të mëdhaja se interesi publik.

5. Numri i kërkesave që nuk kanë marrë përgjigje: -/-

6. Numri i ankesave të parashtruara kundër vendimeve të shkallës së parë (aktvendime të zyrtarëve të infomatave, me përshkrim të vendimit, si dhe me theksim të arsyeve për vendimin e marrë në rast të refuzimit të sërishëm të informacionit të kërkuar): 1 (një).

Aktvendim i Gjykatës së Apelit Gostivar SPI.nr.2/23 nga data 13.01.2023.

Kërkesa është refuzuar në pajtim me nenin 6 paragrafi 1 alineja 2 nga Ligji për qasje të lirë të infomarcioneve nga karakteri publik, sepse nuk është informatë që e ka krijuar ose me të cilën disponon zyrtari i informacionit në çfardo lloj forme, dhe poashtu nuk është informatë që ka ndodhur në kompetenca të cilat i ka Gjykata e Apelit Gostivar, në pajtim me Ligjin për gjykatat dhe rregulloret tjera ligjore.

7. Numri i ankesave të miratuara me vendim të Agjensionit: -/-

8. Numri i vendimeve të shkallës së parë të ndryshuara me veprim të Agjensionit: -/-

9. Numri i ankesave të refuzuara nga Agjensioni dhe arsyet për refuzimin e tyre: 1 (një)

Ankesa e kërkuarit të informacionit nga karakteri publik është refuzuar me vendim të Agjensionit për qasje të lirë të infomacionit nga karakteri publik nr.08-55 nga data 06.02.2023, sepse me informacionin e kërkuar për listë të bisedave telefonike nga telefoni zyrtar i kryetarit të Gjykatës së Apelit Gostivar për periudhën janar 2021 deri në dhjetor 2022 ka hyrje në privatësinë komunikative të përdoruesit të telefonit zyrtar, duke pasur parasysh që thirrjet telefonike paraqesin pjesë nga jeta private e kryetarit të Gjykatës së Apelit Gostivar, me qëllim të përdorimit të telefonit zyrtar në funksion të sigurimit të komunikimit më të lehtë me të punësuarit e tjerë për shkak të kryerjes së lëndëve në afatet e parapara ligjore, ndërsa të punësuarit mund të përdorin telefonat zyrtar edhe për qëllime private, sepse nuk janë përcaktuar kufizime për komunikimin e tyre, nga ku del që edhe e drejta e privatësisë ndërsa në këtë rast çmimi për faturën për përdorim të telefonit zyrtar është informatë e karakterit publik, por jo edhe lista e bisedave telefonike. Nga ana tjetër në këtë rast bëhet fjalë për kërkesa të drejtuara te personat fizik te të cilët mund të bëhet dëm për nderin dhe reputacionin e tyre nëse kjo informatë bëhet publike, por dëmi mund të bëhet edhe ndaj personave të tretë, për shkak të së cilës me refuzimin e qasjes deri te ky informacion i kërkuar, pasojat mbi interesin që mbrohet janë më të mëdhaja se interesi publik.

10. Numri i ankesave të refuzuara nga Agjensioni dhe arsyet për refuzimin e tyre: -/-

SHËNIM: Detyrimet tatimore të përmendura në nenin 36 nënkuptojnë edhe detyrimin tuaj për t'u përgjigjur me saktësi, me të dhëna, komete dhe karakteristika të cilat rrjedhin nga puna juaj.

Gostivar,
Data: 02.01.2024

Poseduesi i informacionit
Gjykata e Apelit Gostivar

Personi zyrtar
Aleksandar Duroski